

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E HËNË 5 DHJETOR 2022

Përshëndetje të gjithëve!

E nderuar drejtuese e seancës,

Kolegë deputetë,

Zonja Ministre e Turizmit dhe Mjedisit,

Të dashur qytetarë,

Kam kërkuar interpelancë me ministren e Turizmit dhe Mjedisit në rrjedhën e një beteje që qytetarët e Divjakës dhe të Lushnjës kanë nisur prej ditësh, të cilët unë kam nderin dhe përgjegjësinë t'i përfaqësoj në këtë sallë. Disa muaj më parë filloi të konkretizohej tentativa për bllokimin e rrugës hyrëse në parkun Divjakë-Karavasta dhe në plazhin publik të Divjakës. Tentative e fillim shtatorit dështoi në mungesë të çdo lloji dokumenti të nevojshëm dhe në paligjshmëri totale. Vendimi për të bllokuar rrugën u kthye mbrapsht në fillim të shtatorit dhe njëkohësisht nxori në pah një luftë të fortë brenda pushtetit socialist, një luftë të egër, e cila i kishte vendosur ata në garë me njëri-tjetrin se kush do të gllabëronte parkun dhe të ardhurat e gjeneruara nga parku Divjakë-Karavasta.

Ndërkohë, në luftën për të aneksuar pasuri publike, askush nuk denjoi të mendonte për vizitorët, për banorët, për bizneset, për trashëgiminë, që Divjaka me banorët e saj e ka mbrojtur edhe fizikisht kur ka qenë e nevojshme, edhe në trazirat më të errëta të këtij vendi, për ta mbajtur një pasuri publike natyrore, unike, të paprekur dhe të larmishme, siç është sot parku Divjakë-Karavasta. Kërkohet me kokëfortësi dhe padije të bllokohet një rrugë kombëtare, e vetmja rrugë nacionale që bën të mundur aksesin në 1250 hektarë park publik, që është nën hapësirën e Bashkisë së Divjakës dhe një gjatësi bregdetare afërsisht 15 kilometër plazh publik.

Rruga në fjalë është nacionale, pjesë e inventarit të rrugëve kombëtare të ARRSH-së, e vetmja me anë të së cilës mund të aksesohet e gjithë kjo vijë bregdetare dhe e gjithë hapësira e parkut Divjakë-Karavasta. Vetëm disa ditë më parë u rivendos bllokimi në hyrje të rrugës nacionale që akseson parkun dhe plazhin, një vendim në arbitraritet dhe në paligjshmëri totale me anë të artificave që ju i keni firmosur enkas, me

qëllimin për ta bërë fakt të kryer dhe për të nënshtruar qytetarët e Divjakës, Lushnjës, vizitorët e parkut e të plazhit, për ta pasur një fakt, ku askush nuk do t'ju kërkonte llogari për këtë arbitraritet, duke shkelur ligjet, dhe në kundërshtim me vendimet e institucioneve të këtij vendi.

Bllokimi i rrugëve të disa ditëve më parë bëri bashkë si rrallëherë, pa ngjyrimë politike, të gjithë banorët e Divjakës dhe të Lushnjës, por me solidaritet edhe të të gjithë shqiptarëve, të cilët nuk do ta pranojnë kurrë nënshtrimin që ju kërkoni t'u bëni. Sot, si rezultat i këtij uniteti, si rezultat i këtij reagimi qytetar, që është për t'u nderuar dhe admiruar, rruga është e lirë dhe Divjaka është krenare dhe dinjitoze për të pritur krahëhapur pa taksa oksigjeni çdo vizitor, vendas e të huaj, që zgjedh të vizitojë parkun e plazhit. Pa dyshim që çdo vizitor është një burim më shumë të ardhurash për bizneset vendase dhe për parkun, duke kontribuar me pagesa prej vitesh në të gjitha atraksionet që janë sot në park dhe që kanë funksionuar prej vitesh.

Njëkohësisht, për të informuar edhe zonjën ministre dhe ministrinë përkatëse, prej vitesh mblidhen pagesa, paguhen tarifa për të vizituar Divjakën, për t'u ngjitur në kullën 360 gradë, (përfitoj të bëj edhe pak reklamë pozitive për Divjakën), ose për të bërë xhiro me varkë. Prej vitesh paguhen para për të gjitha atraksionet që sot funksionojnë në park, si dhe për çdo automjet që akseson rërën në vijën bregdetare gjatë sezonit turistik. Pyetjet e mia janë të thjeshta për ministren e Turizmit dhe Mjedisit:

Zonja Ministre, a keni ju informacion se sa janë të ardhurat vjetore që mblidhen nga Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta? Ku shkojnë këto të ardhura? A keni një studim se sa janë nevojat për mirëmbajtjen e parkut dhe a janë të ardhurat që mblidhen të mjaftueshme për të mirëmbajtur parkun në nivelin që mund të ndërhyjmë, sepse e dimë se parku kombëtar është pjesë e konventës së "Ramsarit" që prej vitit 1996. Jam e sigurt që nuk keni asnjë studim, por vetëm moton tuaj të pandryshueshme: "Vidh e zhvat sa të mundësh".

Zonja Ministre, paratë e mbledhura në parkun e Divjakës (pjesërisht po ju jap një përgjigje pyetjeve të parashtruara prej vitesh) shkojnë në kundërshtim me rregullat e këtij shteti në arkën e Bashkisë së Divjakës, kur, në fakt, institucioni përgjegjës, që duhet t'i menaxhojë për mirëmbajtjen e parkut, është AKZM-ja, drejtoria e Fierit, sipas ligjeve të këtij vendi.

Pyetja ime është: me çfarë baze ligjore paratë, që merren nga parku, i menaxhon bashkia, ndërsa investimet për mirëmbajtjen ia kërkojmë AKZM-ës? Pra, këtu fillon ngërçi, ndaj shqiptarët duhet të dinë se ju nuk keni problemin e mirëmbajtjes së parkut, por keni problemin se si do ta ndani pushtetin dhe kush do t'i menaxhojë paratë që sigurohen nga parku, sepse numri i vizitorëve është i konsiderueshëm.

Vetëm vitin e kaluar kanë hyrë mbi 500 mijë vizitorë në parkun e Divjakës. Në Divjakë ka plot taksa që vijnë nga parku, nga plazhi e të tjera, por kurrë nuk do të ketë një taksë për oksigjenin, për një shëtitje me karrocë fëmijësh apo një taksë për të moshuarit, të cilët duan të bëjnë aty një shëtitje të thjeshtë në këmbë dhe të marrin ajër, oksigjen, jetë, sepse kjo është ajo që ofron Parku Kombëtar i Divjakës. Kjo nuk ndodh në asnjë vend të botës. Në asnjë vend të botës një sipërfaqe e tillë nuk kthehet në një zonë militare, ku duhet të tregohet pasaporta, përveç parave që duhet të paguhen, për t'u futur dhe për të pasur akses në një zonë të tillë.